



ATKINS

Plan per Konsultimin dhe
Komunikimin me Publikun
(PCDP)
PROJEKTI ANTEA CEMENT

Qershor 2007

Plan per Konsultimin dhe Komunikimin me Publikun (PCDP)

NUMRI I PUNES: 504 9164			REFERIMI PËR DOKUMENTIN: Project ANTEA PCDP Final.doc			
5	Versioni përfundimtar për shpërndarje	J Leslie				12/07/07
4	Versioni Përfundimtar	J Leslie	Neil Burke	Neil Burke	A Iles	02/07/07
3	Version 3 për komente	J Leslie	Neil Burke			21/06/07
2	Version 2.1 për komente	J Leslie				
1	Versioni 1 për shpërndarje	J Leslie	Neil Burke	A Iles	A Iles	25/12/06
		Nisi	Verifikoi	Rishikoi	Autorizoi	Data
Inspektimi	Qëllimi Përshkrimi	ATKINS				

PËRMBAJTJA

1. PARATHËNIE

Error! Bookmark not defined.

2.	KËRKESAT KRYESORE RREGULLATORE LIDHUR ME VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR E SOCIAL (ESIA)	1
3.	IDENTIFIKIMI I GRUPEVE TË INTERESIT DHE PROCESI I ANGAZHIMIT	1
4.	INFORMACIONI DHE KENDVESHTRIMET E GRUPEVE TE INTERESIT	1
5.	KONSULTIMET E DERITANISHME E TE ARDHSHEME	1

Lista e Tabelave

Tabela 1.1	Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Sociale gjatë Fazës Ndërtimore të Zhvillimit të Zonës Ndërtimore	1
Tabela 1.2	Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Sociale gjatë fazës së Funkcionimit	1
Tabela 1.3	Përfitime Sociale të Mundshme gjatë Fazës së Funkcionimit në Zonën e Zhvillimit Industrial	1
Tabela 2.1	Përmbledhje e kërkesave kombëtare, të IFC dhe BERZH për konsultime me publikun dhe ndarjes së informacionit	12
Tabela 3.1	Përmbledhje e intervistave sipas vendndodhjes	1

Lista e Ilustrimeve

Ilustrimi 1-1	Hapat dhe Dokumentet për Proceset e Zhvillimit dhe Bashkë-financimit	1
---------------	--	---

SHTOJCAT

Shtojcë 1: Plani i Shtrirjes së Zonës

Shtojcë 2: Fletëpalosje shpërndarë grupeve të intëresit në Maj dhe Qershor 2007

Shtojcë 3: Neni 20 i ligjit 8990 (23/01/2003) 'Mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor' lidhur me çështje të debatit publik

Shtojcë 4: Matricë Përmbledhëse e Analizës së Grupeve të Interesit

Shtojcë 5: Formulari Tip i ANTEA-s për Komunikimin me Publikun

Shkurtesat

ALL	Lek Shqiptar ¹
Dynym	Njehsim i sipërfaqes 10 dynym =1 hektar
EBRD	Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH)
ESIA	Ndikimi Mjedisor e Social
IFC	Korporata e Ndërkombëtare të Financimit
ILO	Zyra Ndërkombëtare e Punës
OD	Dispozita në Fuqi

¹ 1 Euro = 123 ALL

1. PARATHËNIE

Informacion Bazë mbi Zonën e Projektit

- 1.1 Krijimi i një fabrike te re cimentoje shoqëruar me zonat e nxjerrjes së gurit gëlqeror dhe argjilës u është propozuar Autoriteteve Shqiptare dhe ka marrë lejen e nevojshme. Objekti ndodhet në Krujë, në verilindje të Tiranës. Pjesa më e madhe e prodhimit të gurit gëlqeror në vend (80%) dhe një sasi e madhe e agregatëve të tij (20%) nxirret në Krujë.
- 1.2 Vendi i fabrikës së propozuar të cimentos dhe guroreve dhe lidhja e tyre me fshatrat më të afërta paraqitet ne Shtojcën 1. Picrrada dhe Brett (në Bashkinë Krujë) janë, respektivisht, 2.5 - 4.5 km dhe 1.0 – 2.5 km nga fabrika e cimentos dhe guroret. Burizana dhe Thumanë (Komuna Kodër Thumanë) janë respektivisht 5.5 - 8.5 km dhe 2.5 - 4.5km larg.
- 1.3 Zona e projektit ka një popullsi prej 7,465 banorësh ose 1,409 familjesh. Picrraga dhe Brett janë fshatra të vogla kodrinore. Secila prej tyre ka respektivisht 74 dhe 35 familje dhe një popullsi prej 453 dhe 212 banorë. Burizana dhe Thumana kanë shtrirje më të ulët. Ato janë fshatra me 800 dhe 500 familje dhe popullsi 4,200 dhe 2,600, respektivisht. Sikundër Picrraga dhe Brett, këto fshatra, duke pasur rrugë të asfaltuara, kanë transport të arsyeshëm dhe akses ne treg.
- 1.4 Vendi, si dhe zona e projektit, karakterizohet nga nje nivel i lartë papunësie. Si pasojë, familjet janë të detyruara të mbështeten në një shumëllojshmëri punësh të përkohëshme apo sezonale për të plotësuar sigurimin e ushqimit të familjeve të tyre fermere. Fermat në kodrinë - Picrrage dhe Brett - janë 1.3 ha dhe 1.7 ha. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e zonës është tokë kullote e papërpunuar. Rreth 30 – 40% është tokë e lërueshme ose ullishte. Prodhimet përfshijnë foragjere, patate dhe perime. Në Thumanë dhe Burizanë, sipërfaqet e tokës së zotëruar janë të vogla, mesatarisht 1.1 ha. Nga kjo zonë, 65% është tokë e lërueshme ose nën pemë frutore. Pjesa më e madhe e tokës së lërueshme (70%) ujitet.
- 1.5 Të gjitha familjet kanë bagëti për qëllime të sigurimit të ushqimit. Kryesisht, ato përfshijnë: 1 ose 2 lopë, 4 ose më pak kafshë të tjera ripërtypëse dhe nje numër të vogël pulash. Njëmbëdhjetë familje në Brett dhe Picrrage kanë tufa të mëdha, prej 30 - 200 delesh ose dhish.

- 1.6 Duke patur parasysh vendndodhjen si dhe aksesin e cilësinë e dobët të tokës, Brett dhe Picrraga konsiderohen nga zyrtarët lokalë si zonat më të varfra që mbulon Bashkia Krujë. Kryepërqendrimet shprehin nivele të larta papunësie, respektivisht 60% dhe 90%.
- 1.7 Nevojat familjare plotësohen me të ardhura nga burime të tjera jo-fermere, ndërmjet të cilave, përfshihen: prodhimi i gëlqeres, punë lokale të paguara, migrim ekonomik afatgjatë apo sezonal në vendet fqinje, kioska dhe dyqane të vogla në Thumanë dhe Burizanë.
- 1.8 Vendi i propozuar për nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe ngritjes së fabrikës së cimentos do të zëjë një hapësirë prej 25ha. Ai do të shfrytëzojë tokë pyjore kombëtare, e cila do të përdoret në bazë të marrëveshjes me qeverinë. Hapësira për krijimin e një rrugë të re aksesit të propozuar për të lidhur Thumanën me zonën e nxjerrjes së argjilës pranë Brett, kërkon blerjen e 0.6ha tokë nga komuna, e cila prek 7 familje. Zona që do të shfrytëzohet nga fabrika e cimentos dhe guroret, momentalisht përdoret për kullotjen e bagëtisë, mbledhjen e bimëve dhe nxjerrjen e gurit gëlqeror.

Informacion Bazë për fabrikën e cimentos

- 1.9 Objekti i propozuar do të jetë në pronësinë e administrimit të ANTEA Cement, një kompani e re, krijuar si pjesë e Titan Group. Titan është një kompani e madhe, zotëruar nga grekët, që prodhon, ofron dhe tregton cimenton, agregatë, beton për miksturë dhe produkte të tjera të ngjashme për industrinë e ndërtimit. Titan Group ka më shumë se 100 vjet përvojë në këtë industri dhe ushtron veprimtarinë në Mesdhe, Evropën Juglindore dhe SHBA.
- 1.10 Fabrika e propozuar e cimentos do të prodhojë cimento duke përdorur një proces të thatë. Do të jetë e lidhur me shfrytëzimin e dy gurore të reja që do të nxjerrin pjesën më të madhe të materialit bruto (gurin gëlqeror dhe argjil "fysch" [silikat-aluminat]). Fabrika e cimentos do të shtrihet në kodër, në perëndim të Picrragës, në pllajën mbi qytezën e Burizanës.
- 1.11 Fabrika e propozuar e cimentos do të përfshijë:
 - Integrimin e një linje të prodhimit të skories dhe linjës të përpunimit të cimentos në nivelet 3,300 ton/ditë;
 - Skoria do të përdoret për përpunimin e Cimentos se Zakonshme Portland (skories OPC), në bazë të standardeve shqiptare dhe / ose Evropiane;
 - Qymyri dhe/ose koksi do të jenë lëndë djegëse kryesore e furrave të pjekjes;

- Do të merren masa zbutëse për të ulur krijimin e tepërt të pluhurit.

Instalimi i pajisjeve në fabrikë dhe funksionimi i të gjitha proceseve do të hartohen dhe aplikohen në përputhje të plotë me standardet dhe specifikat teknike si dhe në përputhje me praktikat më të mira të BE-së².

Puna Ndërtimore dhe Kampi i Përkohshëm i Punës

- 1.12 Ndërtimi i pjesës më të madhe të fabrikës kërkon fuqi të specializuar punëtore; për këtë arsye, pjesa më e madhe e fuqisë punëtore do të importohet. Gjatë fazës së ndërtimit, do të krijohet edhe një kamp i përkohshëm për pothuaj 700 punëtorë të huaj. Vendndodhja e kampit nuk është finalizuar ende, por pritet të jetë në pllajën pranë zonës së ndërtimit të fabrikës së cimentos. Më shumë detaje do të gjeni në Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA).

Plani për Konsultimin dhe Komunikimin me Publikun dhe Vlerësimi i Ndikimit për Qëllime Bashkë-financimi

- 1.13 Pjesë e procesit të zhvillimit industrial janë një sërë hapash të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar, si dhe të plotësojnë kërkesat ndërkombëtare për financim e bashkë-financim (më shumë detaje në Kapitullin 2). Shkurtimisht, ato paraqiten në Ilustrimin 1-1.

Ilustrimi 1-1 Hapat dhe Dokumentet për Proceset e Zhvillimit Industrial dhe Bashkë-financimit

Fazat e Projektit	Dokumentet e Kërkuara	Hapat e Zhvillimit
1. Zgjedhja e vlerësimi i zonës, vlerësimi i ndikimit mjedisor kombëtar (EIA) për gurorët gëlqerore dhe argjilore, marrja e autorizimit	EIA Kombëtare dhe aplikimi për marrjen e autorizimit	Përfunduar. Aplikimi pranuar.
2. Zgjedhja e vlerësimi i zonës, vlerësimi i ndikimit mjedisor kombëtar (EIA) për fabrikën e cimentos dhe marrja e autorizimit	EIA Kombëtare dhe aplikimi për marrjen e autorizimit - Rishikimi i parë i dokumentit të EIA - Versioni Përfundimtar i EIA	Përfunduar. EIA dorëzuar Autorizimi siguruar.
3. Procesi i Bashkë-financimit	ESIA duhet të paraqesë informacion si kërkesë e agjentëve bashkë-financues: - Plan për Konsultimin dhe Komunikimin me Publikun (PCDP) - Raporti i fushave të vlerësimit - ESIA për Konsultimet	- PCDP dorëzuar dhe tani e disponueshme në zyrën e Antea-s ose faqen e internetit të Titan, në Qershor 2007 - Raporti i fushave të vlerësimit dorëzuar në Qershor 2007.

² Sic specifikohet në Udhëzimin Best Available Technique (BAT) siguruar nga shënimet e EU BREF .

		- ESIA pritet të dalë në Gusht 2007
4. Komunikimet e ardhshme dhe konsultimet gjatë veprimtarisë		Mjetet zyrtare të raportimeve vjetore të ANTEA-s

- 1.14 Kini parasysh se në legjislacionin shqiptar, procesi lidhur me vlerësimin e ndikimit dhe marrjes së autorizimit për projektin e propozuar mban emrin Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (EIA). Ky process përfshin një vlerësim të ndikimeve sociale të projektit të propozuar. Sipas kërkesave të bankave investitore, në thelb procesi është i njëjtë dhe merr parasysh standardet e kërkesat shqiptare, si dhe standardet e kërkesat e BE-së e ato ndërkombëtare. Në këtë dokument ky proces mban emrin Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA). Termi Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor Kombëtar (National EIA) dhe ESIA përdoren në këtë dokument për të bërë dallimin midis EIA Kombëtare dhe ESIA për qëllime financimi apo bashkë-financimi.
- 1.15 Si BERZH, ashtu edhe IFC gjykojnë të marrin përgjegjësi të barabarta në ANTEA Cement. Bankat kanë konfirmuar se ky është një projekt i kategorisë 'A'³ e si i tillë kërkon një vlerësim ESIA të plotë. Ky Plan Konsultimi e Komunikimi (PCDP) është përgatitur në emër të Titan Group në përputhje me procedurat e Bankave.

Objektivat e PCDP

- 1.16 Objektivat e PCDP janë të:
- Përkrahje grupet kryesore të interesit dhe të kuptojë shqetësimet, këndvështrimet dhe interesat e tyre kryesore lidhur me fabrikën e cimentos dhe guroret;
 - Përfshijë këto shqetësime e interesa në kategorizimin e fushave të vlerësimit të ESIA, në mënyrë që shqetësimet e grupeve të interesit të vlerësohen saktë, si dhe të gjenden mënyra për zbutjen e tyre, në rast nevojë;
 - Identifikojë e japë kohë e burime të mjaftueshme për zhvillimin e një dialogu me pjesëmarrje për të hulumtuar alternativa e masa zbutëse, në rast nevojë;
 - Vendosë një formë zyrtare te komunikimit të drejtpërdrejtë të publikut me ANTEAN-n, nëse ekziston dëshira;

³ Një projekt domethënës që do të shfrytëzojë tokë të re dhe që pritet të ketë ndikime të mëdha mjedisore

- Sigurojë informacion mbi planifikimin e përfundimit të draftit të vlerëzimit ESIA dhe konsultimeve mbi gjetjet.

1.17 Ky dokument bazohet në vizita në vendin e projektit dhe fshatrave pranë tij, si dhe intervistave me përfaqësues të Njësisë së Qeverisjes Vendore dhe banorëve të fshatrave ne Kruje, Picrrage, Brett, Burizanë dhe Thumanë në Dhjetor 2006 dhe Qershor 2007.

Ndikimet e Mundshme të Projektit

Tabela 1.1 Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Sociale gjatë Fazës Ndërtimore të Zhvillimit të Zonës Industriale

Aktiviteti	Ndryshimi	Ndikimet e Mundshme	Masat Zbutëse
Kampi i Ndërtimit	Një kamp i përkohshëm për afro 700 punëtorë të huaj me aftësi të specializuara do të akomodohen në Pllajë deri në 30 muaj	Në fshatrat më të afërta përta i përket ndërveprimit me punëtorët e huaj dhe kërkesave për shërbime apo objekte shtesë	Garantimi se kampi është i pajisur në mënyrë të përshtatshme dhe se janë marrë masat e nevojshme nga kontraktuesi e kompania për të siguruar se shërbimet vendore të mund të përmbushin cdo kërkesë shtesë
Zhurma dhe pluhuri	Infrastruktura e re rrugore dhe transporti i mjeteve të rënda	Shqetësime të mundshme në popullsinë vendore si pasojë e zhurmës dhe pluhurit	Përdorimi i praktikave më të mira për të minimizuar shqetësimet që vijnë nga zona e ndërtimit, në përputhje me udhëzimin
Akesi dhe përdorimi i tokës	Guroret dhe fabrika e cimentos do ta kufizojnë përdorimin e kësaj zone specifike për aktivitete të tjera e përdorim nga banorët si më parë	Humbje apo kufizim i mjeteve të jetesës për ata që aksesonin më parë këtë zonë.	Diskutime e konsultime me banorët vendas për të shmangur apo minimizuar ndikimet dhe identifikimin e masave për kompensimin e humbjeve
Emetimet në tokë e sipërfaqe ujore	Nuk pritet ndryshim rrënjësor pasi ka mekanizma kontrolli ujore	Ndikimi në tokë dhe/ose sipërfaqe ujore si pasojë e përdorimit pa kujdes të substancave. Ekziston mundësia e rënies së materialeve të ngurta në sipërfaqet e ujore gjatë ndërtimit	Vendosja e pritave dytësore për pengimin e përhapjes së materialeve të rrezikshme. Sigurimi që i gjithë sistemi i drenazhimit të jetë i kontrolluar për të penguar rënien e materialeve të ngurta si dhe krijimin e sistemit të drenazhimit në vende të posacme.
Rruga dhe	Ndërtimi i dy rrugëve të	Mundësi për aksidente rrugore për këmbësorët	Merr parasysh përfshirjen në hartimin dhe ndërtimin e

transporti	reja. 1) një rrugë e re lidhëse midis gurores argjilore që kalon nga Thumana për t'u bashkuar me Autostradën Nacionale. 2) një rrugë e dytë e re që lidh guroren argjilore me fabrikën e cimentos	dhe përdoruesit e mjeteve të tjera të qarkullimit rrugor, rritje e zhurmës dhe pluhurit nga trafiku.	rrugës, të masave të sigurisë për këmbësorët dhe përdoruesit e tjerë të rrugës (të kompanisë së cimentos dhe individë të tjerë me mjete motorike apo jo-motorike), rajnimeve të përshtatshme dhe fushatave të ndërgjegjësimit drejtuar përdoruesve dhe banorëve.
------------	---	--	--

1.18 Tabelat 1.1, 1.2 dhe 1.3 paraqesin ndikimet e mundshme sociale (pozitive e negative) të projektit gjatë fazës ndërtimore e asaj operacionale. Këto janë marrë nga fletëpalosje e shpërndarë në Qershor 2007 (Shih Shtojcën 2).

Tabela 1.2 **Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Sociale gjatë Fazës së Funkionimit**

Aktiviteti	Ndryshimi	Ndikimet e Mundshme	Masat Zbutëse
Emetimet ne Ajër	Emetimet si pasojë e prodhimit	Përkeqësimi i mundshëm e cilësisë së ajrit përreth në mungesë të masave të duhura zbutëse	Përdorimi i teknologjisë më të mirë do të parandalojë ndikimet madhore. Niveli i emetimit do të jetë nën nivelin që përcakton legjisllacioni shqiptar.
Pluhuri	Shtimi i emetimit të pluhurit ne atmosfere	Përkeqësimi i mundshëm e cilësisë së ajrit përreth në mungesë të masave të duhura zbutëse	Përdorimi i praktikave më të mira për të minimizuar pluhurin, duke përfshirë mbulimin e të gjitha materialeve që transportohen.
Përdorimi i Ujit	Nxjerrja e ujit nga rezervat nëntokësore	Pakësimi i ujit për përdorime të tjera në zonë, psh.: ujë për përdorim familjar ose ujë për furnizimin e vijave ujore natyrore	Minimizimi i përdorimit të ujit duke përdorur teknologjinë më të mirë të disponueshme dhe nxjerrjen e ujit në një hapësirë më të gjerë për të minimizuar ndikimin vendor.
Trafiku	Ndërtimi i rrugës së re për në fabrikë	Ndikim mbi popullsinë vendore nëpërmjet rritjes së zhurmës, pluhurit dhe rrezikut të mundshëm të aksidenteve.	Rruga do të ketë shtrirje të tillë që t'i përshkojë fshatrat deri në pikën më të fundit. Kujdesi me masat e sigurisë për të minimizuar rrezikun e aksidenteve do të paraqitet i detajuar në planifikim.

Tabela 1.3 Përfitime Sociale të Mundshme gjatë Fazës së Funkionimit në Zonën e Zhvillimit Industrial

Aktiviteti	Ndryshimi	Ndikimet e Mundshme	Masat Zbutëse
Punesim lidhur me fabrikën e cimentos	Fronte të reja pune do të hapen, të cilat do t'i shërbejnë projektit në mënyrë te drejtpërdrejtë ose indirekte	Popullsia lokale do të ketë mundësi të aplikojë për punë të ndryshme si dhe të zhvillojë punë ekzistuese ose fillojë punë të reja lidhur me shërbimet, si: furnizimi me ushqim, pastrimi, mirëmbajtja e rrugëve, logjistika, etc.	Perspektiva e vendeve të punës për popullsinë vendore do të rritet nëpërmjet politikave specifike: Do te ofrohen trajnime për zhvillimin e aftësive të nevojshme për punonjësit potencialë në këtë investim të ri.
Punesim lidhur me kampin e ndërtimit	Kërkesa të reja nga kampi mund të rrisin mundësitë për aktivitete tregtare.	Mundësi për të zgjeruar aktivitetet tregtare e ato gjysmë-tregtare, si prodhimin e marketingun e fruta-perimeve, shërbimi i lavanterisë, shitja e pijeve, etj.	Klienti do të nxisë kontraktorët të sigurojnë furnizimet në tregun vendor, aty ku është e mundur.
Buxheti I Bashkisë	ANTEA do të paguajë taksat e biznesit	Rritja e të ardhurave në buxhetin e bashkisë do të rialokohet për zhvillimin e mëtejshëm të Bashkisë së Krujës	Popullsitë lokale nxiten të hartojnë qartë e të prezantojnë nevojat e komunitetit dhe planet e zhvillimit

1.19 Kapitulli 4 i këtij raporti paraqet ndikime të tjera të mundshme të indentifikuara nga grupet e interesit, si dhe përmbledh komentet, shqetësimet dhe pritshmëritë që ata kanë përsa i përket ndikimeve të projektit paraqitur më lart.

2. KËRKESAT KRYESORE RREGULLATORE LIDHUR ME VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR E SOCIAL (ESIA)

2.1 Fabrika e cimentos duhet të përputhet me kërkesat e legjislacionit shqiptar për të siguruar autorizimin për funksionim. Aplikimet për zhvillimin e funksionimin e guroreve dhe fabrikës së cimentos kanë përfunduar e janë në përputhje me legjislacionin shqiptar. ANTEA posedon licensat e nevojshme për fillimin e shfrytëzimit të guroreve dhe krijimit të fabrikës së cimentos.

2.2 Përvec kontrolleve për zhvillimin e funksionimin e tyre nga agjencite rregullatore vendore dhe kombëtare, IFC dhe BERZH kërkojnë që objekti të përmbushë edhe disa kërkesa në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare lidhur me aspektet teknike të ndërtimit e funksionimit dhe aspektet sociale për punëtorët e komunitetin vendor.

Kërkesat Rregullatore Shqiptare

2.3 Ka dy ligje shqiptare për mjedisin që i aplikohen zhvillimit të zonës industriale dhe funksionimit të objektit të propozuar, si më poshtë:

2.4 Ligji 8934 (05/09/2002) për Mbrojtjen e Mjedisit

- Ligji paraqet kuadrin ligjor sipas legjislacionit shqiptar, për të mundësuar kontrollin e ndikimit në mjedis, si rezultat i aktiviteteve industriale duke mundësuar përmbushjen e të drejtës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të shëndetshëm.
- Duke iu referuar projekteve të zhvillimit industrial, ligji detajon se mbrojtja e mjedisit do të arrihet nëpërmjet hartimit të vlerësimit EIA (Kapitulli IV i ligjit) dhe Lejimit të Aktiviteteve që Ndikojnë në Mjedis (Kapitulli V i këtij ligji). Nga ky ligj kuptohet se mbrojtja mjedisore arrihet nëpërmjet dy proceseve të ndara nga njëra-tjetra; e para për kontrollin e zhvillimit dhe e dyta për procesin e lejimit. Kjo përputhet me modelin Evropian të kontrollit legjislativ për kontrollin e zhvillimit e funksionimit të objekteve industriale.

2.5 Ligji 8990 (23/01/2003) mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor

- Kjo është rregullorja kryesore që përshkruan kërkesat e personave të përfshirë në sipërmarrjen industriale e të tjera sipërmarrje të propozuara, për të raportuar ndikimet e mundshme në mjedis.
- Ky ligj detajon tipet e projekteve që kërkojnë një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor (EIA) si dhe paraqet udhëzime lidhur me detajet që ajo duhet të përmbajë.
- Ato aktivitete që ka të ngjarë të kenë ndikim të madh detajohen në Shtojcën 1 të Ligjit 8990 dhe kërkojnë një vlerësim ndikimi 'më të thelluar'. Ato projekte që detajohen në Shtojcën 2 të ligjit kërkojnë fillimisht një përmbledhje të vlerësimit nga agjencia rajonale e mjedisit për të marrë një vendim nëse sipërmarrja kërkon apo jo një vlerësim më të thelluar.
- Propozimet të cilat gjenden në Shtojcën 1 ose 2, kërkojnë një rishikim fillestar nga agjencia rajonale e mjedisit.
- EIA përgatitet nga agjentet e personave të cilët e propozojnë sipërmarrjen dhe rishikohet nga personat kompetente.
- Ligji detajon personat që do të përfshihen me përgatitjen e vlerësimit dhe detajet që duhen për të përgatitur një vlerësim të kënaqshëm.
- Ai gjithashtu detajon kërkesat për konsultime me publikun. Neni përkatës jepet në Shtojcën 3.

2.6 Përqasja me legjislacionin Evropian theksohet në zbatimin e Direktivës në fuqi të BE 97/11/EC për EIA nga legjislacioni shqiptar.

Kërkesat nga IFC dhe BERZH

2.7 BERZH dhe IFC kanë standarde që përcaktojnë rolet e përgjegjësive të klientëve për manaxhimin e projekteve të tyre. Këto kërkesa përfshijnë edhe kërkesën për përhapjen e informacionit.

2.8 Ky projekt është kategorizuar i kategorisë 'A' nga BERZH dhe IFC. Projektet e kategorisë A kërkojnë një Vlerësim Mjedisor (dule përfshirë vlerësimin social) për të garantuar se ato janë të shëndetshme e të qëndrueshme nga pikpamja mjedisore e sociale. Një vlerësim i plotë mjedisor e social (ESIA) duhet t'i nënshtrohet një konsultimi me publikun, të paktën 60 ditë para aprovimit të huasë. Ajo duhet të bëhet e njohur nëpërmjet Eorl Bank Group Info Shop⁴ (dhe Qendrës së Informacionit të Biznesit të BERZH-it në Londër dhe Zyrës Përfaqësuese në Tiranë.

⁴ ëëë.eorlbank.org/ËBSITE/EXTERNAL/PUBLICATION/INFOSHOP1

BERZH do të njoftojë edhe nëpërmjet faqes së internetit ([ëëë.ebrd.com](http://www.ebrd.com)) duke e lidhur ESIA me faqen e sponsorit te projektit ([ëëë.Titan.gr](http://www.Titan.gr)).

2.9 Për më tepër IFC përdor standarde performance⁵ që përfshijnë:

- Vlerësimi Social dhe Mjedisor dhe Manaxhimi i Sistemeve të cilat përcaktojnë rëndësinë e angazhimit të efektshëm të komunitetit nëpërmjet shpërndarjes së informacionit për projektin dhe konsultimeve me komunitetin vendor në çështje që ndikojnë drejtpërsëdrejti;
- Kushtet e Punës dhe Punësimit;
- Parandalimi dhe Pakësimi i Ndotjes;
- Shëndeti, Siguria dhe Sigurimi i Komunitetit që ka si qëllim të shmangë apo minimizojë rreziqet dhe ndikimet në shëndetin e sigurinë e komunitetit vendor gjatë jetëgjatësisë së projektit në rrethana të zakonshme ose jo. Ajo mund të përfshijë dhe të marrë parasysh çështje të prurjes (migrimit) së fuqisë punëtore për periudha të përkohëshme apo të përhershme;
- Përvetësimi i Tokës dhe Ristrehim i Pavullnetshëm sipas të cilës klientët kërkohen të vërtetojnë se procesi i përvetësimit të tokës ka qenë transparent dhe i kënaqshëm dhe se ato nuk janë në kushte me të këqia se sa para projektit. Në vecanti, vlen të përmendet se kjo kërkesë ndikon jo vetëm te njerëzit e zhvendosur fizikisht, por edhe te ato që u ndryshon mënyra e jetesës nga projekti;
- Ruajtja e Biodiversitetit dhe Manaxhimi i Burimeve Natyrore të Qëndrueshme;
- Trashëgimia Kulturore.

2.10 IFC kërkon që më parë klienti të organizojë konsultime të lira e të mirë-informuara dhe të mundësojë pjesëmarrjen e komuniteteve në fjalë. Qëllimi i këtij procesi është të vlerësojë e të kuptojë nivelin e përkrahjes dhe mospajtimit me projektin nga komunitetet e ndikuara.

2.11 Standardet e BERZH mbi aspektet sociale lidhur me praktikat dhe përgjegjësitë e projektit janë standardet më të rrepta kombëtare dhe të BE-së. Ata përdorin Direktivat të Fuqi të Bankës Botërore (OD) për ri-vendosjen/ri-strehimin (OD 4.30), popullsinë indigjene (OD 4.20) manaxhimin e pronës kulturore (OP 11.03)⁶ dhe

⁵ see <http://www.ifc.org/ifcext/enviro.nsf/Content/PerformanceStandards>

⁶ <http://www.ebrd.com/enviro/policy/standard.htm>

standardet e Zyres Ndërkombëtare të Punës (ILO) lidhur me punën e detyruar, punën e fëmijëve dhe diskriminimin.

2.12 BERZH kërkon që para fillimit të punës për vlerësimin ESIA, klienti (sponsori) të hartojë një Plan Konsultimi dhe Komunikimi me Publikun (PCDP). Ky raport ose "Plan" identifikon njerëzit e ndikuar/prekur dhe ato që janë të interesuar në projekt (seksioni 4 i këtij raporti), parashtron mënyrat e komunikimit midis sponsorit dhe grupeve të interesit (seksioni 5 i raportit) dhe se si pikpamjet e tyre do të merren parasysh, si dhe përmban një mekanizëm komunikimi e ankesash (seksioni 5, paragrafi 5.3) me anë të të cilit publiku mund të japë komente në cdo kohë.

2.13 Edhe IFC, edhe BERZH kërkojnë që sipërmarrësi i projektit të konsultohet me grupet e interesit për përgatitjen dhe rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe social, si dhe t'i bëjë publike komunitetit rezultatet e procesit të vlerësimit. Këto kërkesa nuk janë vecse një komunikim i hapur, direkt dhe me nivel me të gjithë individët e grupet që mund të preken nga projekti. Kjo kërkon respektimin e parimeve të mëposhtme:

- Komunikim i shkruar e verbal në gjuhën vendase dhe formularë lehtësisht të kuptueshëm;
- Akses i shpejtë i grupeve të interesit në informacionin e shkruar dhe proceset e konsultimit;
- Përdorimi i metodave verbale apo vizuale për shpjegimin e informacionit;
- Respektimi i traditave vendore të diskutimit, reflektimit dhe vendimmarrjes;
- Kujdes që grupet që konsultohen të jenë të përfaqësuar ndër të tjera me gra, grupe vulnerabël, popullsi indigjenë, minoritete etnike apo fetare (në bazë të lokalitetit), dhe takime të vecanta me grupe të ndryshme, aty ku shihet e nevojshme; dhe
- Mekanizma të qartë për t'iu përgjigjur shqetësimeve, sugjerimeve dhe ankesave të popullit.

2.14 Konsultime me grupe interesi të prekur nga zhvillimi industrial kërkohet minimalisht në dy raste. Konsultimi i parë u jep informacion grupeve të interesit mbi procesin dhe merr mendimin e tyre për studimin e fushave të vlerësimit. Konsultimi i dytë kërkon prezantimin e draftit të vlerësimit ESIA, duke u dhënë mundësi grupeve të interesit të marrin më tepër informacion, të kuptojnë më mirë ndikimet dhe të ngrenë çështje apo shqetësime të tjera.

2.15 Takimet e propozuara me grupet e interesit ne Seksionin 5 të këtij dokumenti.

2.16 Kërkesat e diskutuara në seksionin 2 lidhur me kërkesat të nivelit kombëtare, të IFC dhe BERZH, përmblihen më poshtë:

Tabela 2.1 Përmbledhje e kërkesave kombëtare, të IFC dhe BERZH për konsultime me publikun dhe përhapjen e informacionit

Objektivat e konsultimit	Tematika e konsultimit	Afati kohor i konsultimit	Përgjegjësia për konsultimin
<p>Nivel Kombëtar Të sigurojë këndvështrimet dhe opinionet e grupeve të interesit mbi projektin</p>	<p>Ndikimet e mundshme në mjedis (duke përfshirë ehgd ndikimet sociale)</p>	<p>Brenda 1 muaji nga marrja e vlerësimit EIA nga Ministria e Arsimit. Grupeve të interesit u jepet njoftimi 10 ditë para konsultimit.</p>	<p>Autoriteti Lokal (atëherë kur njotohet nga Ministria e Mjedisit)</p>
<p>BERZH Të sigurojë mundësinë që njerëzit e prekur të mund të shprehin shqetësimet e opinionet e tyre e rrjedhimisht të përmirësojnë cilësinë e projektit.</p>	<p>Hartimi i projektit duke përfshirë vendndodhjen, zgjedhjen teknologjike, dhe afatin kohor para se të meret një vendim financimi nga BERZH.</p>	<p>Konsultimet duhet të fillojnë para e të vazhdojnë gjatë gjithë procesit të vlerësimit EIA. Për kompanitë private, dokumenti përfundimtar EIA duhet të bëhet i disponueshëm 60 ditë para se Bordi I BERZH ta marrë në shqyrtim.</p>	<p>Konsultimi me publikun e diseminimi i infomacionit është përgjegjësi e sponsorit të projektit dmth klientit</p>
<p>IFC Të sigurojë që komunitetet e prekura të jenë të angazhuara në çështje që potencialisht mund të kenë ndikim tek to si dhe të ndërtojnë e të mirëmbajnë marrëdhënie konstruktive me këto komunitete.</p>	<p>Rreziqet dhe ndikimet e pafavorshme sociale e mjedisore dhe masat e veprimet e propozuara për trajtimin e tyre</p>	<p>Për projekte me ndikime të pafavorshme social-mjedisore, procesi i diseminimit të informacionit / komunikimit duhet të nisë herët në process, që në fazën e vlerësimit social-mjedisor. Për projektet e kategorisë A, kjo ndodh të paktën 30 ditë para se Bordi i IFC të marrë vendimin financiar dhe në cdo rast para fillimit të ndërtimit të projektit.</p>	<p>Klienti është përgjegjës për mirëmbajtjen e frymës së angazhimit të komunitetit dhe përhapjes së informacionit / komunikimit.</p>

3. IDENTIFIKIMI I GRUPEVE TË INTERESIT DHE PROCESI I ANGAZHIMIT

Identifikimi i Grupeve të Interesit

3.1 Në Dhjetor 2006, nisën vizitat e fillimit të projektit ku u dha mundësia e parë për të parë vendin e projektit si dhe për të takuar përfaqësues të nivelit kombëtar, rajonal, vendor dhe banorë. Qëllimi i këtyre takimeve dhe intervistave ishte për të:

- Kuptuar proceset industriale, ndikimet e tyre, zhvillimin e mundshëm industrial e proceset e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (EIA);
- Diskutuar dhe identifikuar ndikimet e mundshme të projektit mbi guroret, fabrikën e cimentos dhe rruget;
- Identifikuar zonat me ndikim në të gjithë komponentët;
- Kuptuar përdorimin e tokës vendore, aktivitetet dhe popullsinë që jeton e punon në të osë pranë zonave me ndikim.
- Hartuar një listë me grupet e njerëzve që kanë mundësi të preken nga projekti.

3.2 Grupet e interesit u identifikuan duke u nisur nga afërsia e shtëpive, tokave dhe aktiviteteve të tyre me komponentët e projektit dhe interesat e tyre të mundshme. Grupet e ndryshme të interesit fillimisht u identifikuan në një matrice grupesh interesi, e cila indentifikonte interesat dhe vendndodhjet e tyre të mundshme (Shih Shtojcën 4). Ky raport përqëndrohet në ato grupe interesi që kishin të ngjarë të prekeshin nga projekti, të cilët janë banorë të komunitetit vendor.

3.3 Grupet e interesit përfshijnë:

- Banorë vendas nga Piccraje, Brett, Burizana dhe Thumane;
- Autoritetet vendore nga Kruja dhe Thumana (Keshilli Bashkiak, Kryetari, Autoritetet Shëndetësore dhe Arsimore);

- Grupet vulnerabël, duke përfshirë të moshuar, të rinj apo familje në nevojë. Të moshuarit e të rinjtë mund të kenë nevoja të vecanta shëndetësore ose nevoja të tjera. Mirëqënia e familjeve të varfra (shpesh familje të drejtuara nga femrat) mund të jenë në rrezik më të madh nga një ndryshim i vogël i projektit; madje ata mund të kenë edhe më pak mundësi për të shprehur mendimet e tyre.
- Grupe të vecanta banorësh që mund të mos i ndjekin mbledhjet: gratë, grupet minoritare ose grupet pa epërsi.
- Grupet e shoqërive civile vendore;

Procesi i Angazhimit të Grupeve të Interesit

- 3.4 Diskutimet dhe informacioni fillestare u bënë publike nga studio Silva, të cilët bënë një prezantim në emër të ANTEAs për grupet e interesit në Brett e Picrage në Gusht 2006, për t'u dhënë atyre informacion mbi guroret dhe fabrikën. Një tjetër takim u organizua në praninë e 32 përfaqësuesve në Krujë, më 10 Janar 2007, një prezantim i cili u fokusua në fabrikën e cimentos si pjesë e vlerësimit kombëtar EIA.
- 3.5 Në Qershor 2007, një Ekspert Social vendor u punësua në stafin e Ekspertëve Socialë të ANTEAs. U hartua një listë me vizita e intervista me grupet e interesit ne Picrage, Brett, Thumane dhe Burizanë, asistuar nga Kryetari i Krujes dhe Thumanës, të cilët bënë prezantimet e rastit me përfaqësuesit e komunitetit. Gjithashtu, ato dhanë informacion mbi ndikimet e planifikuara dhe të mundshme ekonomike ne Komunë.
- 3.6 Ne secilin fshat, u bënë intervista me:
- Kryeplakun;
 - Mësuesit e fshatit, personelin e qendrave shëndetësore bashkiake dhe komunale;
 - Gra fshatare dhe të rinj;
 - Rrites bagëtish/barinj;
 - Djegës gëlqereje;

- 3.7 Qellimi i intervistave ishte sigurimi i një tabloje socio-ekonomike të secilit prej fshatrave, mjetet e jetesës ne fshat dhe ndikimin që mund të ketë fabrika e cimentos, gurorja dhe rrugët e reja sipas mendimit të banorëve. Gjithashtu, ne pyetëm të intervistuarit për preferencat e tyre të komunikimit lidhur me projektin.
- 3.8 Intervistat u bënë me banorët dhe autoritetet vendore në secilin fshat. Kjo është periudha më e ngarkuar e vitit për fshatarët dhe shumë prej tyre preferuan të bënin intervista e jo takime. Sic tregohet në tabelën 3.1, u kryen 27 intervista në 5 vendndodhje.

Tabela 3.1 Përmbledhje e intervistave sipas vendndodhjes

Vendndodhja	I intervistuari
Kruja	Kryetari i Bashkisë, Drejtori I Poliklinikës, Doktor i Piccragës, Klubi Ekologjik i Krujës (shoqatë vendore)
Piccragë	Përfaqësues komuniteti, mesues, 3 të rinj, 2 banorë (mashkull dhe femër)
Brett	Përfaqësues komuniteti, mesues, banorë (mashkull dhe femër)
Burizana	Përfaqësues komuniteti, personel i qendrës shëndetësore, 7 banorë (meshkuj dhe femra)
Thumane	Kryetari i Komunës dhe një banor që jetonte pranë rrugës së planifikuar.

- 3.9 Lista e plotë e pyetjeve që u hartuan, mbulojnë aspekte të tilla si:

a) Popullsia: Temat përfshinë: popullsia e fshatit dhe përbërja e tij, struktura e fshatit dhe familjes, numri i familjeve, migrimi, punësia e papunësia, dhe mjeshtëritë vendore.

b) Përdorimi i Tokës: Temat përfshinë: mënyrat kryesore të përdorimit të tokës, madhësia mesatare e fermës, cilësia e tokës, pronësia e tokës dhe aspektet vendore të reformës për pronat, vlera/ha e tokës për qëllime të ndryshme, përdorimi i tokës bujqësore, prodhimet gjatë vitit, aktivitetet dhe puna bujqësore, rëndësia e mënyrës së jetesës vendore dhe ndikimi i kampit, fabrikës së cimentos dhe guroreve në këtë aktivitet.

c) Bagëtia: Temat përfshinë: pronësia e bagëtisë, numri i tyre, mënyrat e kullotjes dhe traditat, zonat e kullotjes, rëndësia e mënyrës së jetesës vendore dhe ndikimi i kampit, fabrikës së cimentos dhe guroreve në këtë aktivitet.

d) Bimët Aromatike e Mjekësore: Temat përfshinë: organizimi i mbledhjes së tyre dhe marketingu, pjesëtarët e familjes dhe numri i tyre që mbledhin bimët, të ardhurat nga aktiviteti, vendndodhja e aktivitetit; rëndësia e mënyrës së jetesës vendore dhe ndikimi i kampit, fabrikës së cimentos dhe guroreve në këtë aktivitet

e) Djegia e gëlqeres: Temat përfshinë: proceset (prerja e druve, copetimi i shkëmbinjve gëlqerorë, djegia e gurit gëlqeror), numri i familjarëve të përfshirë në secilin process, vendndodhja e aktivitetit, të ardhurat nga komponentët e aktivitetit, kërkesat e tregut dhe cmimi, konkurrenca vendore, rëndësia e aktivitetit në mënyrën e jetesës vendore dhe ndikimi i kampit, fabrikës së cimentos dhe guroreve në këtë aktivitet.

f) Shërbimët Publike: Temat përfshinë: kushtet e infrastrukturës vendore dhe cilësia e shërbimeve (uji, ujrat e zeza, energjia, rrugët e transporti), rëndësia në mënyrën e jetesës vendore dhe ndikimi i kampit, fabrikës së cimentos dhe guroreve në infrastrukturë e shërbime.

3.10 Informacioni bazë i mbedhur nga mendimet e shprehura nga banorët paraqitet në Seksionin 4.

4. INFORMACIONI DHE KENDVESHTRIMET E GRUPEVE TE INTERESIT

Këndvështrimet e Banorëve dhe Pritshmëritë e Ndikimeve të Mundshme të Projektit

- 4.1 Picrraga dhe Burizana janë fshatrat më pranë fabrikës së cimentos dhe zonës së nxjerrjes së gurit gëlqeror. Familjet e këtyre fshatrave e shfrytëzojnë zonën për të mbledhur bimë⁷, për të kullotur bagëtinë dhe për të nxjerrë gurin gëlqeror. Fshati Brett është shume afër zonës argjilore. Familjet e Brettit e shfrytëzojnë tokën për kullotjen e bagëtive.
- 4.2 Në të gjitha fshatrat, rritja e bagëtisë është e rëndësishme për qëllime të vetëmjaftueshmërisë. Në Brett dhe Picrrage në vecanti, kultivimi i blegtorisë i është përshtatur zonave kodrinore me cilësi të dobët toke. 11 familje kanë kope të mëdha me bagëti, midis 30 dhe 200 kokë kafshë të vogla ripërtypëse.
- 4.3 Mbledhja e bimëve aromatike dhe mjekësore dhe kullotja shpesh kryhen nga gratë, fëmijët e pensionistët. Aktiviteti mund të sjellë fitime nga 10,000 lekë në 50,000 lekë (€ 80-400) /vit.
- 4.4 Nxjerrja e gëlqeres për arsye shitjeje apo përpunimi kryhet nga burrat e Picrragës (74 familje). Një burrë mund të nxjerrë nga shkëmbi rreth 15-30 m³ gur gëlqeror në muaj ose deri në 210 m³ në vit. Me tarifën €4.8 /m³, sigurohen të ardhura totale vjetore në masën 126,000 Lekë (ose € 1,024). Gëlqerja nxirret në pika të ndryshme duke përfshirë edhe zonën ku do të ngrihet fabrika e cimentos dhe gurorja e gurit gëlqeror. Procesi i djegies së gurit gëlqeror kryhet edhe në Burizanë, por sidoqoftë, këta njerëz e sigurojnë gurin gëlqeror nga verilindja e Krujes.
- 4.5 Udhëheqës të komunitetit dhe djegës të gurit gëlqeror u shprehën gjatë intervistave se:
- “Punësimi që do të krijohet gjatë ndërtimit dhe më pas gjatë funksionimit të biznesit të ri, do t'i largojë banorët nga aktivitetet e tyre aktuale drejt një sigurie më të madhe e më shumë të ardhurave (me punësim të ligjshëm, me sigurime e paga mujore të rregullta). Pagat do të jenë më të larta se sa fitimet në aktivitetet e tyre aktuale”.

⁷ 52 nga 74 familje në Picrrage dhe 120 nga 800 familje në Burizanë

- “Nëse dikush është më tepër i interesuar të rikthehet në punën e mëparshme, brenda territorit të fshatit, ka ende zona të papërdorura për shfrytëzim prej tyre”, (pohime nga djegës të gurit gëlqeror në Picrrage.)
- 4.6 Një fshatar në Brett, i pyetur për humbjen e zonës shfrytëzuar për kullotje, u shpreh se kishte ende një zonë të madhe kullote në pjesën e sipërme të fshatit dhe në zonat e tjerat përfaqësojnë fshatit. Përgjigje e përafërt u mor edhe kur u pyet për çështjen e mbledhjes së bimëve.
- 4.7 Njerëzit që janë duke përdorur ose kanë përdorur zonën aktuale të projektit për qëllime të tilla si, prodhim i gëlqeres, mbledhje e bimëve apo kullotje, do të intervistohen dhe shkalla e zhvendosjes ekonomike dhe masat rregulluese ose riparuese do të identifikohen e paraqiten në vlerësimin ESIA.
- 4.8 Këto fshatra kanë karakteristika të ngjashme demografike me ato që janë gjetur në të gjithë zonën rurale të Qarkut të Krujës. Popullsia ka një përqindje të lartë të moshës së re, nën 15 vjeç (30-40%) dhe një përqindje të vogël të moshës mbi 65 vjeç (10-15%). Popullsia në moshë punë zë 45%-60%. Intervistat me kryepjeqte e fshatrave sugjerojnë se rreth 25% e popullsisë që punon është e përfshirë në migrim sezonal apo afatgjatë për punë. Niveli i papunësisë në zonë është i lartë (në nivelet 60% dhe 90% të popullsisë në kushtë e moshë pune, respektivisht në Brett dhe Picrragë). Për të fituar para e për të mbajtur familjen, rreth 70% dhe 100% e familjeve në Brett, Picrragë dhe Burizanë kanë një ose më shumë se një anëtar të familjes në migrim sezonal apo afatgjatë në vendet përreth. Gjetja e punës është kthyer në stress, ndaj banorët mendojnë se ngritja e fabrikës do ta zbusë këtë.
- 4.9 Fshati Brett do të jetë pranë kreut të rrugës që kalon nga Thumana dhe asaj që do të transportojë argjilin në fabrike. Kamionët që transportojnë cimenton për shitje do të shkëmbehen pikërisht në këtë zonë me kamionët që transportojnë argjilin dhe cimenton nga fabrika. Momentalisht, rruga është e kalueshme vetëm nga makinat 4x4. Asnjë banor i Brett nuk përmendi shqetësim,; sidoqoftë, ata kërkuan përmirësimin e aksesit. Rruga e re e aksesit nga Thumana do të ndikojë drejtpërdrejt në 7 familje të Thumanës, pasi rruga do të kalojë në tokën e tyre dhe ata do të jenë shumë pranë rrugës së re.
- 4.10 Banorët e Thumanës e shohin rrugën e re si një përfitim. Ata dhanë dy arsye. Së pari rruga e planifikuar pritet të përmirësojë aksesin në varrezat e fshatit Thumanë dhe në një vend të shenjtë fetar, Boka e Kuqe. Momentalisht, në këto vende shkohet në këmbë ose me kafshë barre. Rreth 12000 -15000⁸ njerëz i vizitojnë këto vende cdo vit. Ata mendojnë se aksesin më i mirë do të nxisë më shumë vizitorë. Kjo do të ndihmojë zhvillimin ekonomik, do të rrisë kërkesën dhe do të hapë tregun

⁸ Shifrat u konfirmuan gjate intervistave te ndryshme ne tre fshatra te vecanta

për kioskat e dyqanet e vogla. Së dyti, rruga e re do të lidhë fabrikën e cimentos me autostradën nacionale Shkoder-Tirana, e në të njëjtën kohë do të përmirësojnë aksesin e banorëve të Thumanës në autostradë. Banorët mendojnë se kjo do të përmirësojë aksesin e banorëve dhe hapjen e biznesit vendor ndaj tregjeve më të mëdha.

Këndvështrimet e Banorëve për Energjinë, Ujin dhe Kanalizimet

- 4.11 Të 4 fshatrat në projekt furnizohen me energji elektrike nga sistemi qendror nacional i shqërndarjes së energjise. Ndonëse të gjitha familjet mbulohen me shërbim, sistemi karakterizohet nga fluks i ulët ndricimi e ndërprerje gjatë dimrit e verës (nga 12 në 24 orë). Banorët e Picrragës përdorin gjeneratorë të vegjël me naftë. Komunitetet nuk janë të kënaqur me sasinë apo cilësinë e furnizimit me energji elektrike.
- 4.12 Banorët e këtyre fshatrave shpresojnë se në se fabrika e cimentos do të kërkojë 24 orë energji elektrike, nga kjo do të përfitojë edhe komuniteti. Në të njëjtën kohë u ngrit një çështje nga banorët e Burizanës lidhur më ndotjen e ajrit nëse fabrika do të ngrinte një TEC (sic ndodh zakonisht me fabrikat e tjera).
- 4.13 Uji i pijshëm buron nga përrenjtë e Picrragës e Brettit si dhe nga përrenjtë e pusët e Thumanës e Burizanës. Burizana ka tubacione për furnizimin me ujë të 25% të popullsisë. Banorët e Burizanës shprehim shqetësimin se përdorimi i lëndëve eksplozive në nxjerrjen e gurit gëlqeror mund të dëmtojë strukturën e shtresat e nëndheshme të rrjedhjes së ujit e që furnizojnë me ujë të pijshëm fshatin e Burizanës. Në komunën e Thumanës, Antea pranon të përmirësojë furnizimin me ujë të fshatit Derven si pjesë e programit të saj social apo komunitar⁹. Në Picrragë dhe Brett, banorët shpresojnë se furnizimi i ujit me tubacione mund të arrihet ose duke rritur të ardhurat, ose me asistencë të drejtpërdrejtë nga Antea.

Këndvështrimet e Banorëve mbi Ngritjen e Kampit

- 4.14 Udhëheqësit e komunitetit janë të vetëdijshëm se një kamp për akomodimin e 700 punëtorëve të huaj do të ngrihet pranë fabrikës së cimentos dhe zonës së nxjerrjes së gurit gëlqeror për një periudhë 3 vjecare. Ata nuk kanë indentifikuar ndonjë shqetësim dhe u shprehën se mikpritja dhe respekti ndaj të huajve është në traditën shqiptare. Sidoqoftë, ata u shprehën se mungojnë objekte argëtimi, sporti ose ushqime të vecanta (p.sh.: ushqim kinez apo gatime të tjera të vecanta). Informacioni dhe diskutimet e mëvonshme do t'u japin mundësinë banorëve të vlerësojnë një sërë ndryshimesh që mund të vijnë si rezultat i ngritjes së kampit.

⁹ Fshati nuk lidhet drejtpërsëdrejti me zonën e projektit apo me fabrikat

Cështje të tjera të ngritura nga banorët

- 4.15 Informacioni i disponueshëm dëshmon se ka cështje administrative midis banorëve dhe Bashkisë Krujë dhe fshatit lidhur me pronësinë e tokave të cilat bashkia ua ka ofruar më parë banorëve, por ata kanë refuzuar. Me sa kuptohet, këto cështje janë duke marrë zgjidhje nga autoritetet vendore. Detajet mbi këto cështje nuk dihen të plota. Gjatë vlerësimit në këtë zonë, banorët u shprehën se këto janë cështje midis bashkisë dhe fshatit. Ky aspekt do të rishikohet në vlerësimin ESIA.
- 4.16 Kjo cështje do të shqyrtohet më gjatë dhe ecuria e zgjidhjes së saj do të përcaktohet e shprehet në vlerësimin ESIA.

Këndvështrime nga Autoritetet Vendore Shëndetësore dhe Arsimore

- 4.17 Si Picrraga ashtu dhe Brett kanë shkolla që ndiqen nga 65 fëmijë të moshave 6 deri në 14 vjec. Fshati Picrragë ka një shkollë 8-vjecare me fëmijë të moshës 9-14 vjecare që kapin shifrën totale prej 55 nxënës. Brett ka një shkollë fillore (4-vjecare) me 10 fëmijë. Fëmijët nga fshati Brett ecin 2 orë për në Picrragë për të vazhduar ciklin e dytë të arsimit të tyre 8-vjecar. Si rezultat i objekteve arsimore të pamjaftueshme, vetëm gjysma e fëmijëve nga Brett përfundojnë ciklin e dytë të arsimit 8-vjecar. Gjysma e nxënësve përfundojnë arsimin e detyrueshëm në Picrragë e regjistrohen në shkollën e mesme (në një nga shkollat profesionale) në qytetin e Krujës.
- 4.18 Shkolla e Picrragës kupton se një nga skemat që duhet të propozohet nga fshatrat për financim vendor (mundësisht me përkrahje nga ANTEA) mund të jetë një rrugë e re që lidh fshatrat me qendrën. Mendohet se kjo mund të ulë nivelin e braktisjes së shkollës, sidomos nga fëmijët e fshatit Brett. Përmirësimet e infrastrukturës në rrugën që do të lidhë të dy fshatrat mund të krijojnë mundësinë për shërbimin e transportit të fëmijëve me minibus.
- 4.19 Sistemi i shëndetit publik në Krujë konsiston në:
- a) Një rrjet qendrash parësore shëndetësore, me qendra shëndetësore në fshatrat e mëdha e pika të tjera në fshatra më të vogla e lagje;
 - b) Një poliklinikë në qytetin e Krujës; dhe
 - c) Një spital në qytetin e Krujës
- 4.20 Në fshatin Picrragë, qendra parësore shëndetësore ka në staf një infermiere me orar të plotë (ndonëse qendra nuk ishte e hapur ditën e vizites sonë), por mendohet

se objekti e pajisjet të jenë të kufizuara e në kushte jo të mira. Një mjek nga Kruja viziton qendrën një herë në javë. Fshati Brett nuk ka qendër shëndetësore dhe shërbimi i ofrohet nga fshati Picrragë. Në raste urgjencash, banorët udhëtojnë drejt spitalit të Krujës. Një pjesë e këtij udhëtimi prej 6b km, bëhet në këmbë ose mbi gomar pasi infrastruktura rrugore lidhëse është e papërshtatshme.

- 4.21 Burizana dhe Thumana kanë secila nga një qendër shëndetësore me dy doktorë dhe 6-8 infermiere dhe mami. Secila qendër është e pajisur relativisht mirë me mjete për të përmbushur nevojat bazë.
- 4.22 Trajtimet dentare e barnat farmaceutike blihen privatisht në qendrat kryesore lokale.
- 4.23 Në Burizanë, ekspertët e autoriteteve shëndetsore vendore vënë re një tendencë në rritje të rasteve të sëmundjet pulmonare e alergjike tek fëmijët e mosha e tretë. Kjo vjen si pasojë e shtimit të pluhurit nga transporti e rrugët që kalojnë pranë fshatrave. Ata gjithashtu besojnë (bazuar në përvojë e vëzhgime) se punëtorët ose ish-punëtorët e nxjerrjes së gurit gëlqeror në fabrikën e cimentos në Fushë Krujë (që kanë punuar këtu para privatizimit) kanë frekuencë më të lartë të sëmundjeve pulmonare krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë.

Këndvështrimet dhe Pritshmëritë e Këshillit Bashkiak/Komunal

- 4.24 Zonat urbane administrohen nga këshilli bashkiak; zonat rurale nga këshilli i komunës. Cdo këshill ka 13 ose më tepër këshilltarë, në varësi të numrit të popullsisë së zonës. Kruja ka 17 këshilltarë. Nën-ndarjet janë lagjet urbane e fshatrat rurale më kryepiq të zgjedhur.
- 4.25 Të gjitha bizneset paguajnë taksë vendore. Të ardhurat nga taksa e re për fabrikën e cimentos do të gjenerojnë një shtesë prej 60 milion lekë/vit ose € 0.49 milion /vit në buxhetin e Bashkisë Krujë. Këshilli Bashkiak pajtohet me alokimin e buxhetit bazuar në kërkesat konkurruese nga fshatra të ndryshme. Fshatit Brett e Picrragë u alokohet momentalisht 3% të buxhetit aktual. Kryesisht kjo shume mbulon asistencen sociale, pagat e mësuesve dhe mirëmbajtjen e shkollave. Këto fshatra janë të interesuar të dinë si do të alokohen të ardhurat e bashkisë në të ardhmen.
- 4.26 Bashkia sugjeron se rritja e punësimit do ta ulë barrën e “ndihmes ekonomike” ose sistemit të asistencës sociale për familjet e varfra apo të papunët. Sidoqoftë nuk është e qartë niveli në të cilin të varfrit do të përfitojnë e do të kuptojnë ndryshimet. Cdo rritje në punësimin e përhershëm lokal, detyrimisht do të sjellë në të ardhmen pensione më të mira të punëtorëve se sa ajo që ata presin momentalisht.

- 4.27 Këshilli beson se mundësitë e punësimit do të kërkojnë aftësi të reja, e për këtë arsye banorët vendas do të trajnohen nga kompania.
- 4.28 Komuna e Thumanës kishte pritshmëri të ngjashme, përfshirë këtu edhe shpresën se rruga e re do të nxisë biznesin e vogël dhe do të rrisë të ardhurat nga pagesa e taksave/tatimeve vendore.
- 4.29 Drejtori i Pyjeve dhe Mjedisit për qarkun e Krutës identifikoi përfitimet që do të kishte vendi nëse mundësitë e punësimit do ta ulnin aktivitetin e djegies së gurit gëlqeror. Këto aktivitete janë të dëmshme për mjedisin pasi shkaktojnë shpyllëzimin, shfrytëzimin e gurit gëlqeror pa kufizim dhe rritjen e ndotjes së ajrit si pasojë e përdorimit të materialit të gomës si lëndë djegëse.

Grupet Vulnerabël

- 4.30 Vëmendje e vecantë ju dha indentifikimit të ndikimit të projektit në grupet vulnerabël. Ekspertët e shëndetit publik diskutuan mbi ndikimin e pluhurit në shëndetin pulmonar të fëmijëve dhe të moshuarve në Burizanë. Ata mendojnë se kjo vjen nga gjendja e rrugës aktuale dhe trafiku. Gratë, fëmijët dhe të moshuarit merren me kullotjen e bagëtisë dhe mbledhjen e bimëve ndërsa gratë dhe fëmijët mbushin ujë. Asnjë nga burrat e gratë e intervistuar nuk përmendën ndikimin e këtyre aktiviteteve në dimensionin e kohës, vështirësivë ose të të ardhurave; sidoqoftë, ne do t'i konfirmojmë këto në një takim të ardhshëm.

Fuqia Punëtore e Kampit të Ndërtimit

- 4.31 Fuqia punëtore përbën një grup interesi të rëndësishëm. Momentalisht, po hartohen planet për ndërtimin e kampit dhe punëtorisë së tij. Kampi do të akomodojë 700 punëtorë të huaj, të cilët priten të qëndrojnë në vendin e punës deri në 3 vjet. Vlerësimi ESIA do të përfshijë informacion për kushtet e jetesës e të punës së punëtorëve të huaj, informacion për vendndodhjen e ngritjen e kampit, si dhe bashkëveprimin e ndikimin e mundshëm në fshatrat për qark. Takime e intervista të tjera me komunitetin për hartimin e vlerësimit ESIA do të organizohen në Korrik 2007, të cilat do të shqyrtojnë ndikimet e mundshme të kampit si dhe mjetet aktuale a alternative për ngritjen e tij.
- 4.32 Vlerësimi ESIA do të përfshijë e do të japë informacion për sa më poshtë:
- Vendndodhja e kampit;
 - Ambjentet akomoduese, shëndetësore, pushuese dhe argëtuese (përfshirë objekti kulti sipas kërkesës) në total dhe për person;

- Infrastruktura e kampit (energjia, uji, kanalizimet dhe largimi i mbeturinave);
- Ekspertiza në punë e fuqisë punëtore, aftësia për të komunikuar dhe mënyrat e komunikimit për punëtorët e huaj;
- Rekrutimi i punëtorëve, jetesa e punëtorëve si dhe kushtet e punës (paga, numri i orëve të punës, shëndeti dhe siguria, si dhe transportimi në dhe nga vendi i punës);
- Përputhje me standardin e performancës 2 të IFC dhe standardet themelore të punës të Zyrës Nderkombëtare të Punës (ILO) lidhur me organizatat e punëtorëve, mungesa e diskriminimit dhe shanset e barabarta, puna e të miturve, puna e detyruar dhe kushtet e jetesës;
- Bashkëveprim i mundshëm me fshatrat dhe qytezat përfaqar (p.sh.: kërkesat për mallra e shërbime, shpenzime, etc.).
- Cështje të tjera lidhur me shëndetin publik.

5. KONSULTIMET E DERITANISHME E TE ARDHSHME

Aktiviteti Konsultativ i Deritanishëm

- 5.1 Janë organizuar takime me autoritetet vendore dhe kryepleqtë e fshatrave të Krujës lidhur me 2 guroret dhe fabrikën e cimentos. Banorët e fshatit Brett dhe Picrragë kanë marrë pjesë në takimet e Tetorit 2006. Një tjetër takim u organizua në Janar për vlerësimin e ndikimit mjedisor (EIA Kombëtare) dhe procesin e autorizimit.
- 5.2 Në Qershor 2007 u organizuan intervista e diskutime në Krujë, Picrrage, Brett, Burizanë dhe Thumanë. Ndërkohë, bëme publike edhe një fletëpalosje informative (Shtojca 2). Ajo u shoqërua me një formular për komunikimin me publikun (Shtojca 5). U dha edhe nje shpjegim për procesin e komunikimit, si të regjistrohej një shqetësim, ankesë apo kërkesë për informacion të mëtejshëm. Kjo shpjegohet më poshtë.

Proceset e Komunikimit

- 5.3 Të gjitha komunikimet (shqetësimet, ankesat apo sqarimet lidhur me cdo aspekt të projektit dmth planifikimin, mjetet e konsultimit, faza ndërtimore ose funksionale e objektit, ose kampi i punëtorëve) rreth projektit do t'i drejtohen Znj. Dobi, ANTEA, Rruga luigi Gurakiqi, P. 89, Seksioni A, Kati I 10, Tirana, duke përdorur formularin e komunikimit ose nëpërmjet numrit të telefonit: 569 2090547.
- 5.4 Regjistrimi i të gjitha korespondencave të marra është në përgjegjësinë e ANTEA Cement në Tiranë. ANTEA do të përgjigjet me shkrim duke informuar të interesuarit në se dhe cfarë veprimesh do të ndërmerren. Një kopje e çështjeve dhe shqetësimeve do të shqyrtohet nga manaxheret e ANTEA Cement e më pas ajo do t'i përcillet Atkins për të garantuar përfshirjen e çështjeve në vlerësimin ESIA. Pas përfundimit të ESIA, manaxherët eprorë të ANTEAs dhe manaxheri i Përgjegjesisë Sociale të Korporatës TITAN do të jenë ekipi përgjigjës për monitorimin e punës. Do të monitorohen të tëra korespondencat e marra, si dhe vendimet dhe veprimet lidhur me ndërtimin, funksionimin e objektit dhe kampit të fuqisë punëtore.
- 5.5 Përvec këtij mekanizmi, banorët e komunës mund ti drejtohen me shkrim përfaqësuesve të komunitetit ose Bashkisë Krujë pranë zyrës së ankimimit publik. Pas diskutimit, korespondencat do t'i përcillen kryetarit dhe ANTEA-s.

Aktivitetet e Planifikuara të Komunikimit për Vlerësimin ESIA

- 5.6 Intervistat dhe diskutimet e Qershorit 2007 kanë dhënë informacionin bazë, si dhe një sërë këndvështrimesh, interesash e çështjesh lidhur me projektin, të cilat janë përfshirë në studimin e fushave të vlerësimit ESIA. Një takim tjetër me burrat e gratë e Piccragës do të organizohet në mes të Korrikut. Qëllimi i këtij takimi do të jete:
- Të rishikohet në detaj cdo lloj shqetësimi mbi aktivitetet aktuale shkaktuar nga vendndodhja e fabrikës së cimentos, si dhe të kuptohet shtrirja, vendndodhja dhe disponueshmëria e burimeve alternative të gurit gëlqeror e bimëve mjekësore.
 - Të njoftohen banorët për planet e ngritjes së kampit të propozuar si dhe infrastrukturës së tij (uji, largimi i mbeturinave dhe energjia);
 - Të njoftohen banorët për pritshmëritë e furnizimit me energji elektrike.
- 5.7 Drafti përfundimtar i vlerësimit (ESIA) do të dalë në gusht. Udhëheqësve të komunitetit të 4 fshatrave do t'u shpërndahen kopje të materialit. Një kopje e plotë bashkë me përmbledhjen do t'u jepet këshillave të komunës Thumane dhe bashkisë Krujë për inspektim nga publiku. Dokumentet do të jenë gjithashtu në faqet e internetit të bankës (www.ebrd.com) dhe kompanisë Titan (www.Titan.gr).
- 5.8 Raporti do t'u prezantohet grupeve të interesit në Krujë, Thumanë dhe Piccragë. Në secilin vend, do të hapim një ekspozitë me postera për 3 ditë, në mënyrë që banorët të kenë mundësi të informohen me gjetjet e raportit (ESIA). Detajet e vendeve përkatëse do të konfirmohen nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore dhe përfaqësuesve të komunitetit. Në përfundim të këtyre 3 ditëve, do të ketë një përfaqësues për t'u përgjigjur të gjitha pyetjeve. Do të veme në dispozicion një libër për komente në secilin prej këtyre vendeve, si dhe do të informojmë për kohën se kur përfaqësuesi do të jetë i gatshëm për diskutimet. Cdo koment që merret në këtë fazë, do të rishikohet nga ekipi teknik i vlerësimit ESIA dhe cdo ndryshim i nevojshëm do të përfshihet në dokumentin përfundimtar, i cili më pas do t'u prezantohet Bordeve të të dy institucioneve financuese për të marrë një vendim lidhur me bashkë-financimin.

Komunikimi gjatë Fazës Ndërtimore dhe Funksionale

- 5.9 Konsultimet me grupet e prekura duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në varësi të rreziqeve dhe ndikimeve që dalin gjatë fazës ndërtimore e funksionale të fabrikës dhe guroreve.

- 5.10 Ky detaj mbetet ende për t'u diskutuar me ANTEAn dhe do të detajohet në vlerësimin ESIA dhe plan-veprimin përkatës.